



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 20, datë 11.06.2025



PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK PËRSA I PËRKET LISTAVE TË PËRFITUESVE, BANORË NË BANESAT INDIVIDUALE, TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE Durrës, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 164, DATË 19.2.2020, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE Durrës, BASHKIA Durrës, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE"

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.2.2020, "Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese", Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 6, të VKB nr. 33, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 4, 5, Rrashbull, Sukth, Manëz dhe Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë z. Maliq Kulla me numër rendor 1 për arsye se rezultoi e dëmtuar përpara tërmetit të datës 26.11.2019.
2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 9, të VKB nr. 24, datë 03.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 3, 4, 6, Sukth dhe Ishëm, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Petro Dedja me numër rendor 25 për arsye ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 8, të VKB nr. 100, datë 30.03.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe Njësitë Administrative Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Manëz, Ishëm, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga kjo listë znj. Mereme Gashi me numër rendor 9 për arsye se ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
4. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 7, të VKB nr. 77, datë 10.08.2020, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 1, 2, 4, 5, 6, Sukth, Katund i Ri, Ishëm dhe Manëz, Bashkia Durrës”, duke hequr nga kjo listë z. Danjel Mehmeti me numër rendor 19 për arsye se ka dhe pronë tjetër me funksion banimi.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës


Denisa Luarasi

U shpall sot me datë 16.06.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

BASHKIA DURRE
18/6/25 Nr. 6672/10

Nr. 402/1 prot.

Durrës, më 18.06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.20 datë 11.06.2025, "Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit Bashkiak përsa i përket listave të përfituesve, banorë në banesat individuale, të cilët kanë përfituar nga programi i precesit të rindërimit të zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative Durrës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.02.2020, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësine Administrative Durrës, Bashkia Durrës dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese".

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi e Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) i ndryshuar "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

